



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

VENDIM

Nr. 22, datë 21.01.2025

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga raportore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
 2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares, bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjorë në vendimet burim vlerësimi për gjyqtaren {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri për analizën e veprës penale lidhur me fajësinë e autorëve të akuzuar dhe në arsyetimin i kushton rëndësi të gjithë elementeve të veprës penale dhe analizës së provave (shih 3 dokumentet e dosjen 1), si dhe ndalet me kujdes tek dënimi penal. Tre dokumentet e përzgjedhur prej saj dhe 4 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë e gjera të saj, ku bie në sy e drejta penale (shih 3 dokumentet e dosjet 1 e 2), masat e sigurimit në procesin penal (shih dosjen 3), si dhe sekuestrim pasurie, bazuar në ligjin nr.10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (shih dosjen 4). Zbaton me korrektesë procedurën e gjyqimit të shkurtuar (shih dokumentet 1, 2 e dosjen 1). Nga vëzhgimi i dosjes 5 evidentohet se ajo ka njohuri dhe në fushën civile, ku kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile dhe duke e zgjidhur drejt çështjen në gjykim, për pasojë palët nuk e kanë kundërshtuar vendimin e dhënë në gjykatat më të larta (shih dosjen 5)”*.

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Vendimet gjyqësore burim vlerësimi në rastin konkret ndahen në dy grupe kryesore për shkak të lëndës, kategorizim i cili afekton edhe mënyrën e përcaktimit dhe analizimit të fakteve të çështjes. Për shkak të natyrës së ndryshme të burimeve të vlerësimit, analiza e elementeve të këtij treguesi bëhet në mënyrë të veçantë.

Në çështjet civile- Paraqitja e rrethanave procedurale përgjithësisht përbën pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me elementët e juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore në shqyrtimin e çështjes (*elementë të cilët analizohen në çdo vendim burim vlerësimi*), evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për ndryshimin e objektit të padisë,¹ apo (ii) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për thirrjen në gjykim të personit të tretë.² Pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron rrethanat e faktit objekt gjykimi, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat e faktit” duke i parashtruar ato në mënyrë të plotë, të

¹Vendimi nr.62-2014-541 (227), datë 18.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

²Vendimi nr.62-2014-1029 (417), datë 01.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

qartë dhe duke integruar përmbajtjen e provave dhe analizën e tyre, së bashku me faktin, në varësi të volumit të rrethanave të faktit, sipas kërkesës objekt shqyrtimi.

Në çështjet penale, referuar natyrës së gjykimit (*gjykim penal themeli ose kërkesë penale*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi specifike përcaktimit të fakteve të çështjes dhe përshkrimit në mënyrë të detajuar të tyre në një ose disa pjesë të arsyetimit të vendimit, në varësi të kompleksitetit të faktit penal apo volumit të rrethanave të faktit të cilat determinojnë edhe mënyrën e paraqitjes dhe analizimit të tyre.

Gjyqtarja përgjithësisht evidenton në një nënndarje të veçantë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit rrethanat e faktit sikurse kanë rezultuar gjatë fazës së hetimit paraprak, veprimet procedurale dhe provat e marra gjatë fazës së hetimeve paraprake.³ Në një nënndarje të dytë, pjesë e vlerësimit të gjykatës për faktet, përshkruhen rrethanat e faktit të rezultuara si të provuara gjatë gjykimit, shoqëruar më pas me ndarjen dhe renditjen e provave respektive, në mënyrë të veçantë për secilin element të faktit të vlerësuar të rëndësishëm, lidhur me provueshmërinë e elementëve të figurës së veprës penale dhe lidhjen e autorit apo autorëve, me kryerjen e veprës. Paraqitja dhe analiza e provave në drejtim të evidentimit të faktit objekt gjykimi dhe rëndësia që i kushtohet evidentimit të fakteve thelbësore dhe provueshmërisë së secilit prej tyre, është karakteristike e pjesës përshkruese-arsyetuese të të gjithë vendimeve objekt vlerësimi të gjyqtares.

Analiza e rrethanave të faktit në pjesën e dytë, që përbën edhe faktin penal që ka rezultuar i provuar gjatë gjykimit, bëhet duke i kushtuar rëndësi të posaçme analizës së provave në raport me secilin fakt, në mënyrë specifike. Kjo pjesë e paraqitjes së faktit penal, përveç evidentimit të provave për secilin fakt të veçuar nga gjyqtarja si të rëndësishëm në raport me provueshmërinë, shoqërohet në pjesën e vlerësimit të gjykatës, në raport me aspekte të faktit penal të marra në analizë sa i përket provueshmërisë së elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale, posaçërisht elementët e bashkëpunimit;⁴ format e veçanta të bashkëpunimit dhe faktet që provojnë ekzistencën e këtyre formave;⁵ mbetjen e veprës penale në fazën e tentativës;⁶ formës së kryerjes së veprës penale;⁷ apo autorësinë, cilësinë dhe rolin e secilit të pandehur në faktin penal të provuar, etj.

Në çështjet me objekt sekuestrimin e pasurisë,⁸ gjyqtarja i kushton rëndësi të veçantë fakteve të çështjes, jo vetëm duke i përshkruar, por edhe duke i analizuar në mënyrë të plotë

³Vendimet nr.2, datë 07.01.2016, nr.60, datë 11.05.2015, nr.118, datë 26.10.2015 dhe nr.76, datë 30.05.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁴Vendimi nr.118, datë 26.10.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁵Vendimet nr.60, datë 11.05.2015 dhe nr.76, datë 30.05.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁶Vendimet nr.2, datë 07.01.2016, nr.74, datë 10.06.2015 dhe nr.14, datë 04.02.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁷Vendimi nr.60, datë 11.05.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁸Vendimi nr.13, datë 27.07.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

dhe të detajuar ato, si përsa i përket procedimit penal me të cilin lidhet procedimi pasuror, ashtu edhe përsa i përket përshkrimit dhe analizës së procedimit pasuror dhe fakteve që kanë rezultuar për shkak të tij.

- **Identifikimi i natyrës së çështjes:**

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara (*civile dhe penale*), natyra juridike e çështjes është e qartë dhe rezulton nga objekti i gjykimit dhe analiza e faktit penal ose civil, pavarësisht se nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur nga gjyqtarja në të gjitha vendimet. Identifikimi dhe përshkrimi i qartë dhe i saktë i faktit juridik prej saj, sjell si pasojë përcaktimin e saktë të marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve në rastin e çështjeve civile, apo të e natyrës së çështjes penale objekt shqyrtimi, si dhe përcakton mënyrën e organizimit të arsyetimit të vendimit, e cila është e ndryshme në bazë të lëndës (civile, kërkesë penale apo çështje penale themeli).

- **Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:**

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se në të gjitha vendimet, gjyqtarja identifikon qartë ligjin e zbatueshëm, citon në disa raste dispozita të ligjit material ose procedural, por në mënyrë të kufizuar dhe vetëm në raste kur citimi i tyre i shërben analizës ligjore të dispozitës.

Duke i ndarë burimet e vlerësimit në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e problemeve dhe situatave procedurale, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (*çështje me objekt zgjidhje e kontratës së qeras, padi marrëdhënie pune dhe njohje pronar me parashkrim fitues*), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil, ashtu edhe ligjeve organike përkatëse, që kanë lidhje kryesisht me:

(i) *Zgjidhjen e kontratës së punës*, ku gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 12, 144, 145, 153 të Kodit të Punës, në raport me llojin e marrëdhënies së punës dhe mënyrën e zgjidhjes së saj. Në këto çështje, gjyqtarja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm edhe “Rregulloren mbi sigurinë e përdoruesve dhe “Rregulloren për veprimet e arkëtarit në degët/agiencitë e bankës”, në kuadër të vlerësimit të humbjes së mirëbesimit, si një nga shkaqet justifikuar për zgjidhjen e marrëdhënies së punës.⁹

(ii) *Fitimin e pronësisë me parashkrim fitues*, duke cituar ligjin e zbatueshëm, dispozitën materiale civile (*nenin 169 të K.Civil*) në funksion të zgjidhjes së çështjes referuar objektit dhe shkakut ligjor të padisë për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, si dhe ligjin e posaçëm nr. 7501, datë

⁹Vendimi nr. 62-2014-2030 (700), datë 03.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

19.07.1991“Për tokën”, kur analizon origjinën e pronësisë objekt gjykimi. Citon nenin 170 të K.Civil në lidhje me të drejtën e paditësit për të kërkuar me padi kundrejt atij që e ka të regjistruar sendin, fitimin e saj me parashkrim fitues dhe si pasojë regjistrimin e sendit nga organi kompetent shtetëror (*personi i tretë në këtë gjykim*).¹⁰

(iii) *Detyrimet që rrjedhin nga mospërmbushja e marrëdhënieve kontraktore*, duke cituar dhe identifikuar për këtë qëllim si dispozitat e përgjithshme të lindjes së detyrimeve (*neni 419, 420 të K.Civil*), ashtu edhe dispozitat materiale në lidhje me marrëdhënien juridike të detyrimit konkret dhe pasojat që rrjedhin nga mospërmbushja e detyrimit (*neni 812 i K.Civil*).¹¹

Sa i përket ligjit procedural të zbatueshëm, në vendimet civile, gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën hyrëse të pjesë përshkruese-arsyetuese, por edhe në pjesën e vlerësimit të gjykatës, dispozitat procedurale, në lidhje me vendimmarrjen mbi kërkesat për ndryshimin e objektit të padisë (*neni 185 i K.Pr.Civile*), apo thirrjen e personit të tretë (*neni 193 i K.Pr.Civile*), etj. Në arsyetimin e vendimeve citohen dispozitat procedurale civile (*nenet 36/1, 41, 42, 43, 47*), në lidhje me përcaktueshmërinë e juridiksionit dhe kompetencës lëndore dhe tokësore të shqyrtimit të çështjes.

Në çështjen me objekt sekuestrimin e pasurisë gjyqtarja përcakton ligjin e zbatueshëm, nenet 3, 11, 12, 14, 15 të ligjit të posaçëm me nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, lidhur me fushën e zbatimit të këtij ligji, kriteret për sekuestrim të pasurisë, procedurën dhe afatin për shqyrtimin e sekuestrimit, ekzekutimin e masës dhe caktimin e administratorit për pasurinë e sekuestruar.

(ii) Në vendimet penale, gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi specifike identifikimit, referimit dhe analizës së ligjit të zbatueshëm, procedural dhe material, në vendin e duhur të pjesës arsyetuese dhe në shërbim të analizës ligjore të çështjes.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në vendimet penale të analizuara, gjyqtarja identifikon saktë dispozitat materiale penale, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurve. Konkretisht, gjyqtarja identifikon nenet specifike të Kodit Penal mbi të cilat bëhet kualifikimi ligjor i faktit/fakteve penale, për të cilat akuzohen të pandehurit në çdo çështje dhe konkretisht (i) nenin 319/ç të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”;¹² (ii) nenin 283/a/2 të Kodit Penal sa i përket veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve”;¹³ (iii) nenin 128/b/3 të Kodit Penal sa i përket veprës penale të “Trafikimit të të miturve”;¹⁴ (iv) nenet 79/b, 278/3 dhe 283/1 të Kodit Penal lidhur me veprat penale “Vrasje të punonjësit të policisë së

¹⁰Vendimi nr.62-2014-1029 94170, datë 01.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

¹¹Vendimi nr. 62-2014-541 (227), datë 18.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

¹²Vendimi nr.118, datë 26.10.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

¹³Vendimet nr.14, datë 04.02.2015, nr.2, datë 07.01.2016, nr.76, datë 30.05.2016 dhe nr.74, datë 10.06.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

¹⁴Vendimi nr.14, datë 04.02.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

shtetit”, “Mbajtje pa leje në banesë të armëve luftarake” dhe “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të personit të dyshuar për të cilin kërkohet vendosja e një mase sigurimi personal.¹⁵ Në analizën e subjektit veprës penale të “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, gjyqtarja identifikon nenet 1 dhe 9 të ligjit nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” në funksion të argumentimit se i pandehuri merr cilësinë e funksionarit të drejtësisë dhe hyn në rrethin e subjekteve të posaçme, sipas nenit 319/ç të K.Penal.

Gjithashtu, gjyqtarja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, si:

- (i) nenin 25 të Kodit Penal në lidhje me bashkëpunimin, kuptimin e tij, elementët e anës objektive dhe subjektive të bashkëpunimit kur ai përben rrethanë cilësuese të veprës penale;
- (ii) nenin 22 të Kodit Penal në lidhje me kuptimin e tentativës dhe përcaktimit të përgjegjësisë penale kur vepra mbetet në këtë fazë;¹⁶
- (iii) nenin 3 të Kodit Penal në lidhje me përcaktimin e zbatimit të ligjit penal material në kohë, si dhe zbatimin e ligjit penal favorizues;¹⁷
- (iv) format e veçanta të kryerjes së veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve” apo “Trafikimi i të miturve”, duke iu referuar për përcaktimin e tyre dispozitës së posaçme të Kodit Penal;
- (v) kriteret ligjore të individualizimit të dënimit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke referuar parashikimet e nenit 47, 48 49 dhe 50 të Kodit Penal të cilat janë referuar dhe analizuar në secilin nga vendimet penale të themelit;
- (vi) nenet 30/1, 35 dhe 44/1 të Kodit Penal në lidhje me dënimin plotësues për heqjen e së drejtës të ushtrimit të një profesioni ose të një veprimtarie dhe mënyrën e vuajtjes së tij.¹⁸

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, referuar natyrës së çështjes (*çështje penale të fazës së hetimit apo themeli*) apo rritit të gjykimit (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*) gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale: nenin 128 të K.Pr.Penale lidhur me pavlefshmërinë e akteve; nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Penale në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar;¹⁹nenin 93/1 të K.Pr.Penale në lidhje me ndarjen e çështjes;²⁰ nenet 152 dhe 380 të K.Pr.Penale në lidhje me vlerësimin e provave dhe provat që mund të përdoren për të marrë vendimin; nenin 377 të K.Pr.Penale në lidhje me kalimin e akteve prokurorit;²¹ nenin 258/1 të K.Pr.Penale sa i përket afatit të paraqitjes së kërkesës për vleftësimin e arrestit apo ndalimit,²² nenet 228, 229, 230, 251, 252, 259/3 të

¹⁵Vendimi nr.193, datë 29.04.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

¹⁶Vendimet nr.2, datë 07.01.2016, nr.74, datë 10.06.2015, nr.14, datë 04.02.2015 dhe nr.76, datë 30.05.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

¹⁷Vendimi nr.60, datë 11.05.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

¹⁸Vendimi nr.118, datë 26.10.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

¹⁹Vendimet nr.118, datë 26.10.2015, nr.74, datë 10.06.2015, nr.2, datë 07.01.2016, nr.14, datë 04.02.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

²⁰Vendimet nr.2, datë 07.01.2016, nr.60, datë 11.05.2015 dhe nr.76, datë 30.05.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

²¹Vendimi nr.91, datë 30.06.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

²²Vendimi nr.407 akti, datë 19.09.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

K.Pr.Penale në lidhje me konceptin e “dyshimit të arsyeshëm”, kushtet dhe kriteret ligjore të caktimit të masave të sigurimit personal dhe përshtatshmërinë e tyre;²³ nenin 288/3 të K.Pr.Penale dhe nenin 21 të ligjit nr.8811/2001 lidhur me afatin e shqyrtimit të kërkesës për autorizimi nga organi përkatës, në rastet e arrestimit në flagrancë ose ndalimit të subjektit të posaçëm;²⁴ nenin 193/5 të K.Pr.Penale në lidhje me efektet e vendimit të formës së prerë ndaj bashkë të pandehurve;²⁵ nenet 393/1 dhe 485 të K.Pr.Penale lidhur me shpenzimet procedurale dhe ato gjyqësore në procesin penal; nenin 190/1 të K.Pr.Penale në lidhje me disponimin për provat materiale.

Në disa raste, gjyqtarja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm, për të nxjerrë kuptimin e dispozitave të veçanta të ligjit penal shqiptar, edhe dispozita të akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të se drejtës, si më poshtë:

- (i) nenin 1, germa “m” e Konventës mbi drogat narkotike, e vitit 1961, e ndryshuar nga Protokollin i vitit 1972, në lidhje me transferimin fizik të drogave nga një shtet në një shtet tjetër;²⁶
- (ii) Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit ratifikuar me ligjin nr.9492, datë 13.03.2006, si dhe Konventën Penale për Korrupsionin, Seria e Traktateve Europiane/173, ratifikuar me ligjin nr.8778, datë 26.04.2001 lidhur me korrupsionin pasiv.²⁷

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

KONKLUZIONI

Në tërësi, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, konkretisht për llojin e gjykimit të proceduar në çështjet penale, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët procedurale lidhen në trajtimin e kërkesave të tilla, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Po ashtu rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe të integruar me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

²³Vendimi nr.193, datë 29.04.2015, nr.32, datë 15.02.2016 dhe nr.407 akti, datë 19.09.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

²⁴Vendimi nr.118, datë 26.10.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

²⁵Vendimi nr. 2, datë 07.01.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

²⁶Vendimet nr.74, datë 10.06.2015, nr.76, datë 30.05.2016, nr.2, datë 07.01.2016, nr.14, datë 04.02.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

²⁷Vendimi nr.118, datë 26.10.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t’i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit...Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjet e përzgjedhura me short evidentohet se subjekti i rivlerësimit njih dhe në disa raste i përdor shprehimisht në arsyetimin e vendimeve parimet e përgjithshëm të së drejtës, si parimi i ekonomisë gjyqësore apo drejtësisë efektive, e prezumimit i pafajësisë. Ajo kujdeset për zbatimin e tyre në gjykimin e çështjes siç është e drejta e të pandehurit për mbrojtjen me avokat të zgjedhur, apo procesi i rregullt ligjor. Në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit ajo përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese (shih dokumentet 1, 2 e dosjen 1). Gjithashtu ka raste kur referohet në normat kushtetuese, primet kushtetuese, si dhe referohet në KEDNJ dhe standardet e GJEDNJ (shih dokumentin 1 e dosjen 3)”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u

shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk është i pashoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së çështjes.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

Në vendimet civile: Përgjithësisht, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin abstrakt të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike evidentohet se gjyqtarja:

- (i) Interpreton në mënyrë literale dhe teologjike nenin 12 të K.Punës, në funksion të identifikimit të llojit të kontratës lidhur mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës. Pas kësaj analizë, gjyqtarja ndalet në interpretimin e nenit 153 të K.Punës, duke analizuar dy kushtet kryesore për t'u plotësuar në mënyrë kumulative që zgjidhja e marrëdhënies së punës të jetë e rregullt dhe e justifikuar (*kushtet subjektive dhe kushtet objektive*), për të konkluduar se marrëdhënia e punës ka përfunduar me shkaqe të justifikuara, dhe si rrjedhim rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj.²⁸
- (ii) Merr në analizë institutin e fitimit të pronës me parashkrim fitues, si nga mënyrat origjinale të fitimit të pronësisë, duke interpretuar dispozitat relevante (*nenet 169 dhe 170 të K.Civil*) në drejtim të përcaktimit të kushteve kumulative që duhet të plotësohen për ekzistencën e saj dhe legjitimitetin e palës së paditur.²⁹

Në vendimet penale të analizuara, gjyqtarja interpreton normën përkatëse të K.Penal në mënyrë abstrakte, duke dhënë kuptimin e saj, duke evidentuar dhe analizuar elementët e figurës së veprës penale konkrete, posaçërisht (i) format e veçanta të kryerjes së veprës penale të "Trafikimit të narkotikëve" apo të "Trafikimi i të miturve" (ii) qëllimin kur ai përbën element të domosdoshëm për ekzistencën figurës së veprës penale (iii) rrethanat cilësuese të tilla si kryerja e veprës penale më shumë se një herë ose në bashkëpunim (iv) kuptimin dhe zbatimin e neneve të pjesës së përgjithshme të tilla si bashkëpunimi, format e veçanta të bashkëpunimit, kriteret e përcaktimit të llojit dhe masës së dënimit, etj. Analiza ligjore në nivel teorik, shoqërohet menjëherë me aplikimin mbi elementë të faktit të provuar në gjykim dhe më pas me konkluzionin e arritur mbi kuptimin e ligjit dhe zbatimin e tij mbi faktin konkret.

Krahas interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi edhe *interpretimit të dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal* në lidhje me (i) bashkëpunimin si rrethanë cilësuese ose rënduese, duke u ndalur posaçërisht në elementet e anës objektive dhe subjektive të tij, si dhe natyrën e marrëveshjes për kryerjen e veprës penale (ii) zbatimin e ligjit penal favorizues (iii)

²⁸Vendimi nr. 62-2014-2030 (700), datë 03.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

²⁹Vendimi nr. 62-2014-21029 (417), datë 03.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

kriteret ligjore të individualizimit të dënimit duke referuar parashikimet e nenit 47, 48, 49, 53 dhe 59 të Kodit Penal, duke interpretuar në mënyrë logjike dhe sistematike dispozitat penale. Në analizën e ligjit në raport me përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, gjyqtarja ka analizuar në mënyrë të posaçme kuptimin e nenit 53 në lidhje me uljen e dënimit në minimum, si dhe kushtet dhe kriteret që duhet të ekzistojnë për aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, referuar nenit 59 të K.Penal. Interpretimi ligjor është bërë duke i dhënë përgjigje edhe pretendimeve të mbrojtjes së të pandehurve për aplikimin ose jo të këtyre dispozitave.

-Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale:

Gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi vetëm në vendimet penale të analizuara, interpretimit të normës, jo vetëm përsa i përket zgjidhjes në themel të çështjes, por edhe zgjidhjes së situatave procedurale, në rastin e kërtimeve të palëve, mënyrës së marrjes dhe vlerësimit të provave, etj. Konkretisht gjyqtarja interpreton:

- (i) nenin 403 të K.Pr.Penale në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar dhe vlerësimin e gjykatës në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore të këtij neni, me pasojë pranimin e kërkesës;
- (ii) nenin 152 të K.Pr.Penale në lidhje me vlerësimin dhe çmuarjen e provave;
- (iii) nenin 193/5 të K.Pr.Penale në lidhje me efektet e vendimit të formës së prerë ndaj bashkë të pandehurve të tjerë sa i përket vlerës së tij në gjykim, si dhe efektet e këtij vendimi në raport me ekzistencën e faktit penal;
- (iv) Në kërkesën penale, me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi, në funksion të vlerësimit të kushteve të ligjshmërisë së arrestimit, konceptit të flagrancës (nenet 251, 252 dhe 258/1 të K.Pr.Penale në raport me parashikimet e nenit 27 të Kushtetutës), përcaktimit nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit dhe vlerësimit lidhur me përshtatshmërinë e saj (nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale), gjyqtarja bën interpretimin teorik të dispozitave, duke dhënë kuptimin e tyre, si dhe duke përcaktuar kushtet dhe kriteret ligjore për aplikimin mbi rastin konkret. Interpretimi në standardit të “dyshimit të arsyeshëm”, mbështetet edhe në referimin në qëndrimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në vendimin 489, datë 12.12.2000.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, posaçërisht në rastet që lidhen me:

- (i) *Dëmshtëpërblimin që rrjedh nga marrëdhëniet e punës.* Konstatohet se nga ana e gjykatës është cituar dhe zbatuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë korrekte vendimi unifikues nr. 19, datë 15.11.2007 i Gjykatës së Lartë.³⁰
- (ii) *Gjykimin e shkurtuar;* Konstatohet se nga ana e gjyqtarës është cituar dhe zbatuar në pranimin ose jo të kërkesës për të proceduar me gjykim të shkurtuar, vendimi unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 i

³⁰Vendimi nr. 62-2014-2030 (700), datë 03.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe standardin kushtetues në lidhje me këtë institut të vendosur në vendimin nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese.³¹

- (iii) Vlerësimin lidhur me formën e kryerjes së veprës penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike” dhe mbetjen e saj në fazën e tentativës, duke referuar edhe vendimi unifikues nr. 3, datë 24.1.2011 të Gjykatës së Lartë;
- (iv) *Institutin e bashkëpunimit*, referon vendimet unifikuese nr. 1, datë 26.03.2002 dhe nr. 4, datë 15.04.2011 të Gjykatës së Lartë, mbi bashkëpunimin në përgjithësi si formë e kryerjes së veprës penale nga ana objektive;
- (v) *Caktimin e masave të sigurimit*; Gjykata mbështet konkluzionin e saj në ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm dhe caktimit të masës së sigurimit ndaj personit nën hetim, në përputhje me orientimet e vendimit unifikues nr. 7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

-Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsyetimit dhe konkluzionit të arritur. Gjyqtarja njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit siç janë:

- (i) *Parimi prezumimit të pafajësisë*, sanksionuar në nenin 4 të K.Pr.Penale, në nenin 30 të Kushtetutës apo në nenin 6, pg 2 të KEDNJ-së, dhe parimin procedural penal që ka lidhje të drejtpërdrejtë me përgjegjësinë penale të autorit “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*”;
- (ii) *Parimin e ligjshmërisë – nullum crimen, nulla poena sine culpa*, i identifikuar dhe i nxjerrë nga konteksti i arsyetimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të analizuara.
- (iii) *Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit*. Në caktimin e masës së dënimit gjykata ka analizuar parimet kryesore të dënimit penal si një masë shtrënguese kundër personit fajtor që ka kryer veprë penale, *si parimin e ligjshmërisë, individualizimit të dënimit, të dobishmërisë së dënimit dhe të përshtatshmërisë së dënimit (proporcionalitetit)* sipas nenit 47 dhe 47/2 të K.Penal.
- (iv) Parimin e Kodit Penal lidhur me *zbatimin e ligjit më të favorshëm për të pandehurin*, me qëllim përcaktimin e ligjit penal të zbatueshëm, duke analizuar dhe evidentuar dy ligjet (i) ligjin e kohës së kryerjes së veprës penale dhe (ii) ligjin e kohës së gjykimit të veprës penale, në respektim të nenit 3 të K.Penal.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit material dhe procedural në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter civil apo penal. Evidentohet një kujdes i lartë i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor.

³¹Konstatohet identifikimi i vendimit unifikues në të gjitha vendimet penale themeli burim vlerësimi

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes. Vendimi gjyqësor nuk duhet të dominohet nga përshkrimi i provave, por nga pjesa analitike, e cila në vetvete duhet të jetë koncize, pa përsëritje dhe të trajtojë çështjet thelbësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “...*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Në çdo rast respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe përgjithësisht përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe....*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjuha e përdorur nga gjyqtarja në vendimet përfundimtare, gjatë gjykimit dhe në aktet procedurale të dosjeve të analizuar është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme për pjesëmarrësit në proces, si dhe për lexuesin e akteve.

Në arsyetimin e vendimeve rezulton se gjyqtarja zbaton rregullat gramatikore, të sintaksës dhe morfologjisë, në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes apo shprehjes së mendimit juridik të saj.

Përdor përgjithësisht të gjitha shkronjat e alfabetit shqip (jo gjithmonë konstatohet përdorimi i shkronjës “ç” dhe “ë”).

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, nuk rezulton përdorimi i termave latine,³² por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe.

Në të gjitha vendimet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë përdorur terma teknikë apo fjalë që krijojnë konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren, përveç termave të referuar në përshkrimin apo citimin e përmbajtjes së provave të tilla siç janë aktet e ekspertimit, terma të cilët janë të njohur dhe kuptimi i tyre është i qartë nga konteksti apo lloji i provës në të cilën janë fiksuar këto terma.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe shpesh herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsytimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Vendimet janë të organizuar në nënndarje, të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit dhe shpesh identifikohen me fjali tematike.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira të arsytimit ligjor në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Mënyra e zgjedhjes, përdorimi i fjalëve dhe organizimi i arsytimit të vendimit gjyqësor në drejtim të shprehurit me gjuhë të thjeshtë dhe koncize, i bën vendimet të qarta dhe të kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

³² Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën apo cilësinë e një vendimi gjyqësor, duke qenë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ-së shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mos njohësit e ligjit.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet me argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumentave ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*), etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Struktura e vendimeve të saj është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Ajo përmban të gjithë elementet e kërkuar nga legjislacioni procedural penal e ai civil sipas rastit. Subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e akteve dhe organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të kënaqshëm...”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Vendimet përfundimtare të gjyqtarës, referuar kategorisë së çështjes dhe kompleksitetit të përmbajtjes së vendimit, ndjekin përgjithësisht strukturë të njëjtë brenda së njëjtës kategori. Të gjitha vendimet civile dhe penale, përmbajnë elementët e domosdoshëm të vendimit gjyqësor sipas parashikimeve të nenit 310 të K.Pr.Civile dhe nenit 383 të K.Pr.Penale.

Në vendimet civile, pjesa përshkuese arsyetuese e vendimit, përgjithësisht është e strukturuar në nënndarje të cilat janë titulluar sipas përmbajtjes së tyre, duke filluar me “Rrethanat e çështjes” dhe “Arsyetimin ligjor”, pjesë në të cilën gjyqtarja analizon: (i) çështjet e kompetencës dhe juridiksionit civil, për të vijuar më pas me kërkesat procedurale që kanë rezultuar gjatë shqyrtimit të çështjes në themel (ii) rrethanat e fakteve të çështjes të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim; (iii) Pretendimet e palëve gjatë gjykimit dhe (iv) Vlerësimi i gjykatës në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionin e saj.

Në çështjet penale, në varësi të objektit të çështjes apo kompleksitetit të saj, vendimet përfundimtare të vëzhguara janë të organizuara sipas një strukture përgjithësisht të njëjtë, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe dispozitivin e vendimit. Pjesa hyrëse e të gjitha vendimeve përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë ose objektin e kërkesës dhe nenet përkatëse të Kodit Penal, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në mënyrë të plotë ose të përmbledhur.

Pjesa përshkuese-arsyetuese e vendimeve në çështjet e kategorisë “krime”, fillon me një nënndarje të titulluar: (i) “Rrethana procedurale”, evidentohen dhe analizohen elementë procedurale të tillë si refuzimi apo pranimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar, ndarjen ose jo të çështjes etj. (ii) “Hetimet Paraprake”, ku evidentohen rrethanat e faktit siç rezultojnë nga hetimi paraprak, pavarësisht rritit të gjykimit, gjykim i zakonshëm³³ apo gjykim i shkurtuar.³⁴ (iii) “Rrethanat e faktit”, ku gjyqtarja përshkruan rrethanat e faktit siç kanë rezultuar të provuara në gjykim. (iv) “Analiza e provave të shqyrtuar në gjykim” gjyqtarja përshkruan provat e marra gjatë gjykimit, jo vetëm duke i listuar ato formalisht, por edhe duke i pasqyruar ato sipas përmbajtjes së tyre.³⁵ (v) “Analiza ligjore” ose “Vlerësimi i gjykatës”, ku gjyqtarja merr në analizë të detajuar jo vetëm ligjin e zbatueshëm dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionin e saj, por njëkohësisht edhe institute e parime të së drejtës, në funksion të argumentimit ligjor. (vi) “Pretendimet e mbrojtjes”, duke i kushtuar një vëmendje në mënyrë të veçantë pasqyrimin të pretendimeve të mbrojtjes. (vii) “Caktimi i llojit dhe masës së dënimit” ku gjyqtarja analizon lidhur me përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit dhe pjesë në fund të së cilës evidentohen edhe disponimet lidhur me kërkesën për disponimin mbi provat materiale, si dhe për përcaktimin e institucionit në të cilin do të vuhet dënimi për të pandehurin

³³ Vendimet nr.60, datë 11.05.2015 dhe nr.76, datë 30.05.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

³⁴ Vendimet nr.118, datë 26.10.2015 dhe nr.2, datë 07.01.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

³⁵ Vendimet nr.60, datë 11.05.2015, nr.74, datë 10.06.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur jo vetëm disponimin e gjykatës mbi padinë e evokuar nga paditësi (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë në çështjet civile*), por njëkohësisht edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Në vendimet penale dispozitivi përmban disponimin për fajësinë e të pandehurve, nenet respektive të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykitimit të shkurtuar kur është rasti, kohën e fillimit të llogaritjes së dënimit, institucionin e vuajtjes së tij, disponimin e plotë për provat materiale, shpenzimet procedurale, si dhe të drejtën e ankimit. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e plotë, e lexueshme dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet lidhur me të gjithë elementët e disponimit në vendimin përfundimtar.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi të mira në ndjekjen e një strukturë të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme si në aspektin e përmbajtjes ashtu edhe atë vizual, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimit: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përse u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.³⁶

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

³⁶Vendimi i GJEDNJ, çështja *Hadjanastassiou vs Greqisë*, datë 16.12.1992, fq.33.

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetim ligjor....Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i jep rëndësi analizës së normës ligjore, e cila paraqitet e thjeshte dhe e kuptueshme. Në dispozitivin e vendimit disponohet për kërkimet kryesore rreth objektit të çështjes, për llojin dhe masën e dënimit dhe mënyrën e ekzekutimit të tij, për shpenzimet e përlllogaritura gjyqësore, për të drejtën dhe afatin e ankimit, për datën dhe vendin e shpalljes së vendimit. Nuk ka asnjë vendim të cenuar nga gjykatat më të larta për shkak të mungesës së arsytimit të vendimit. Niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Ajo i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme, tek te cilat nuk mungon arsytimi, duke treguar shkakun dhe bazën ligjore (shih dosjet 1-5)”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsytimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale Arsytimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse.

Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo asaj penale, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak–pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore të faktit penal, duke qenë se rëndësia e lidhjes shkakësore qëndron në kuptimin ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale. E parë në mënyrë më konkrete, në lidhje me sa më sipër konstatohet se:

Në vendimet civile gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, p.sh: (i) institutin e fitimit të pronës me parashkrim fitues, si nga mënyrat origjinale të fitimit të pronësisë, duke zbërthyer dhe analizuar në

mënyrë të detajuar kushtet e kumulative që duhet të përmbushen për të qenë para kësaj mënyre të fitimit të së drejtës së pronësisë. (ii) Institutit juridik të dëshmshpërblimit në rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, duke analizuar në mënyrë të posaçme elementët e kontratës së punës, formën e saj, dhe kushtet kryesore që duhen plotësuar në mënyrë kumulative që zgjidhja e marrëdhënies së punës të jetë e rregullt dhe e justifikuar (*kushtet subjektive dhe kushtet objektive*), për të konkluduar se marrëdhënia e punës ka përfunduar me shkaqe të justifikuara, etj.

Në vendimet penale të analizuara, gjyqtarja tregon kujdes në analizimin e plotë dhe të qartë të faktit penal, analizon në mënyrë të detajuar dhe logjike provat, duke i integruar ato me analizën ligjore të dispozitave të zbatueshme, si në lidhje me aspektet procedurale ashtu edhe në raport me kualifikimin ligjor të faktit penal. Karakteristikë e gjyqtares është analiza e qartë dhe e plotë e faktit, shoqëruar me analizën e plotë të provave dhe veçanërisht përcaktimin e vlerës provuese të tyre, në veçanti dhe në tërësi. Në rastet komplekse, gjyqtarja grupon dhe analizon së bashku provat në raport me faktin penal, duke evidentuar në përfundim të analizës së tyre, konkluzionet lidhur me faktet që kanë rezultuar të provuara. Karakteristikë e gjyqtares është integrimi në mënyrë logjike dhe në vendin e duhur i dispozitave ligjore të zbatueshme. Në vijim të analizës gjyqtarja interpreton dispozitat mbi faktin konkret dhe vijon me konkluzionin e arritur. Midis analizës së faktit, interpretimit dhe zbatimit të ligjit, ka rrjedhë logjike.

Në secilin vendim penal të analizuar, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), analiza dhe arsyetimi shtjellohen në mënyrë logjike, duke integruar interpretimin dhe analizën ligjore të elementëve të veprës penale, koncepteve dhe instituteve, me analizën e fakteve të provuara në gjykim. Paraqitja dhe analiza e elementëve të faktit penal në lidhje me veprën penale si dhe autorësinë, si në pjesën ku fakti paraqitet në një nënndarje të veçantë, ashtu edhe në pjesën e arsyetimit ligjor të gjykatës ku ai integrohet në mënyrë të natyrshme me analizën ligjore, e bën atë një analizë të plotë dhe të gjithanshme.

Karakteristikë e gjyqtares është analiza më e detajuar e fakteve esenciale të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim në lidhje me elementë të anës objektive dhe subjektive të veprës penale, autorësinë e të pandehurit dhe rolin e tij, paraqitjen dhe analizën e plotë të provave në lidhje me secilin fakt. Në cilësinë e analizës spikat lidhja në mënyrë të drejtpërdrejtë e faktit/fakteve të provuara, me elementët e figurës së veprës penale, të analizuar më parë, duke evidentuar qartë dhe në mënyrë të natyrshme lidhjen shkak-pasojë.

Interpretimi ligjor i dispozitave dhe më pas analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale në raport me faktet e provuara në gjykim, e bën arsyetimin e vendimeve cilësor dhe përmbush kërkesat e një arsyetimi logjik, përfshirë edhe zgjidhjen e situatave procedurale.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në vendimet penale gjyqtarja ndalet dhe analizon në mënyrë shteruese çdo pretendim të ngritur gjatë gjykimit, si në lidhje me kualifikimin juridik të veprave penale, ashtu edhe pretendimet për pafajësinë. Po kështu edhe në vendimet civile të analizuar evidentohet se pretendimet e palëve merren gjithmonë në shqyrtim dhe analizohen në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, duke u dhënë një përgjigje të argumentuar dhe duke u analizuar në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre. Ato integrohen natyrshëm në arsytimin tërësor të vendimit gjyqësor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentit logjik ndjek rregullin : fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, në shërbim të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “Shume e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

Nivelin e vlerësimit	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar

efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj si kur gjykon e vetme, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtaren {...}, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga dita e marrjes së akteve me short deri në dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme. Kohëzgjatja më e shkurtër ka qenë 1 ditë (shih dosjet 3 e 4), ndërsa kohëzgjatja më e lartë ka qenë 3 muaj e 24 ditë (shih dosjen 5)... Përsa i përket 2 çështjeve të tjera penale ato janë përfunduar brenda afatit procedural penal 48 orë, bazuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale, apo afatit ligjor 5 ditor bazuar në nenin 12 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 (shih dosjet 3 e 4)...”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për 4 (katër) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e gjykimit.

Konkretisht:

- (i) Çështja e kategorisë “Kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake” (*vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit*), për të cilën është parashikuar si afat ligjor për përfundimin, afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë. Referuar vendimit nr. 407 akti, datë 19.09.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda rezulton se kërkesa për vleftësimin e arrestit dhe

caktimin e masës ka si datë regjistrimi datën 18.09.2015 dhe datë vendimi datën 19.09.2015. **Rezulton që është respektuar afati 48 orë i parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale për përfundimin e saj.**

- (ii) Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë, parashikuar në nenin 12, pika 1 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" (sipas formulimit të dispozitës në kohën e zhvillimit të gjykimit), shqyrtohej nga gjykata, me pjesëmarrjen e prokurorit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes, në bazë të dokumenteve të paraqitura prej tij. Referuar vendimit nr.13, datë 27.07.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda rezulton se kërkesa është regjistruar po në datën 27.07.2016, **duke u shqyrtuar brenda ditës, në respektim të afatit ligjor për përfundimin saj.**
- (iii) Çështjet e kategorisë "Kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake" (caktim mase sigurimi), për të cilat është parashikuar si afat ligjor për përfundimin e tyre, afati 5 ditor nga momenti i regjistrimit në gjykatë. Referuar vendimeve me nr.193, datë 29.04.2015 dhe nr.32, datë 15.02.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda rezulton se kërkesat për caktimin e masës **janë shqyrtuar respektivisht për 1 dhe 3 ditë, duke respektuar afatin 5 ditor të parashikuar në nenin 244 të K.Pr.Penale.**

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat për 4 (katër) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe të gjitha këto çështje rezulton të kenë përfunduar brenda afatit ligjor, pra raporti i shprehur në përqindje është 0 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me treguesin "Respektimi i afateve ligjore" gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtaren {...}, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga dita e marrjes së akteve me short deri në dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme. Kohëzgjatja më e shkurtër ka qenë 1 ditë (shih dosjet 3 e 4), ndërsa kohëzgjatja më e lartë ka qenë 3 muaj e 24 ditë (shih dosjen 5). Në dy rastet e tjera gjykimet kanë zgjatur 2 muaj e 9 dite (shih dosjen 1) dhe 23 dite (shih dosjen 2). Nga analiza e këtyre të dhënave, në raport me standardin kohor 12 mujor për çështjet penale të gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, sipas pikës 5 shkronja "f" të Aneksit I të Sistemit të Vlerësimit, konstatohet se dy çështjet janë përfunduar brenda afateve standard...Duhet evidentuar se edhe dosja 5 sipas të dhënës, në raport me standardin kohor 6 mujor për çështjet civile të gjykatës së shkallës së parë, sipas pikës 5 shkronja "e" të Aneksit I të Sistemit të Vlerësimit, konstatohet se është përfunduar brenda afatit standard. Për 3 dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit është analizuar kohëzgjatja, sipas attributeve të shënuara në hyrje të tekstit të vetë vendimit. Kjo e dhënë nuk tregon saktësisht datën e marrjes së akteve me short nga gjyqtarja, por i referohet datës së regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Nga analiza e tre dokumenteve është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë në të tre rastet brenda afateve standard 12 mujor të Sistemit të Vlerësimit dhe konkretisht: 3 muaj e 2 ditë (shih dokumentin 1), 6 muaj e 1 ditë (shih dokumentin 2) dhe 7 muaj e 2 ditë (shih dokumentin 3)”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se për 7³⁷ çështje të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, gjykimi në përgjithësi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së.

Për çështjet e kategorisë “Penale themeli”, në vendimin nr. 261/2 parashikohet se gjykimi në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda duhet të gjykohen brenda standardit minimal kohor prej 12 muajsh.³⁸ Sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit për 7 (shtatë) çështjet e kësaj kategorie, rezulton si më poshtë:

- (i) Çështja që i përket vendimit nr.60, datë 11.05.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është regjistruar në datën 09.10.2014.³⁹ Gjykimi ka

³⁷Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykim.

³⁸Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: *“Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si më poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm...f. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë për krimet e rënda, jo më tej se 12 muaj”*

³⁹Nuk ka të dhëna për datën e shortimit të çështjes për shkak se i përket vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim.

përfunduar në datën 11.05.2015, duke zgjatur gjykimi 7 muaj e 4 ditë ose 214 ditë, ***brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda.***

- (ii) Çështja që i përket vendimit nr.118, datë 26.10.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është regjistruar në datën 24.07.2015.⁴⁰ Gjykimi ka përfunduar në datën 26.10.2015, duke zgjatur gjykimi rreth 3 muaj e 4 ditë ose 94 ditë, ***brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda.***
- (iii)Çështja që i përket vendimit nr.2, datë 07.01.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është regjistruar në datën 06.07.2015.⁴¹ Gjykimi ka përfunduar në datën 07.01.2016, duke zgjatur gjykimi rreth 6 muaj e 5 ditë ose 185 ditë, ***brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda.***
- (iv)Çështja që i përket vendimit nr. 14, datë 04.02.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është regjistruar në datën 20.11.2014 dhe me shortin e datës 25.11.2014 i është caktuar gjyqtarës në cilësinë e relatores/kryesueses të trupit gjykues. Gjykimi ka përfunduar në datën 04.02.2015, duke zgjatur gjykimi rreth 2 muaj e 11 ditë ose 71 ditë, ***brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda.***
- (v) Çështja që i përket vendimit nr. 91, datë 30.06.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është regjistruar në datën 03.06.2016 dhe me shortin e datës 07.06.2016 i është caktuar gjyqtarës në cilësinë e relatores/kryesueses të trupit gjykues. Gjykimi ka përfunduar në datën 30.06.2016, duke zgjatur gjykimi 23 ditë, ***brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda.***
- (vi)Çështja që i përket vendimit nr.74, datë 10.06.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është regjistruar në datën 03.04.2015 dhe me shortin e datës 09.04.2015 i është caktuar gjyqtarës në cilësinë e relatores/kryesueses të trupit gjykues. Gjykimi ka përfunduar në datën 10.06.2015, duke zgjatur gjykimi rreth 2 muaj e 1 ditë ose 32 ditë, ***brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda.***
- (vii) Çështja që i përket vendimit nr.76, datë 30.05.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është regjistruar në datën 17.04.2015 dhe me shortin e datës 21.04.2015 i është caktuar gjyqtarës në cilësinë e relatores/kryesueses të trupit gjykues. Gjykimi ka përfunduar në datën 30.05.2016, duke zgjatur rreth 1 vit, 1 muaj e 9 ditë ose 404 ditë, tej afatit të standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda. Afatit standard minimal kohor është tejkaluar me 39 ditë, por këtu duhet të mbahet në vëmendje edhe fakti se muaji gusht (30 ditë) përkon edhe me

⁴⁰Nuk ka të dhëna për datën e shortimit të çështjes për shkak se i përket vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim.

⁴¹Nuk ka të dhëna për datën e shortimit të çështjes për shkak se i përket vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim.

pushimet vjetore të gjyqtarëve e në këtë kontekst nuk duhet të përlllogaritet në afatin e përfundimit të çështjes duke rezultuar tejkalimi i standardit me vetëm 9 ditë dhe si i tillë çështja do të konsiderohet se ka përfunduar ***brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda.***

Për çështjet e kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” në vendimin nr. 261/1, të viti 2010 të KLD-së, parashikohet standardi minimal kohor 6 muaj për përfundimin e gjykimit. Sa i përket kohëzgjatjes së gjykimit për 3 (tre) çështjet e kësaj kategorie, rezulton si më poshtë:

- (i) Çështja që i përket vendimit nr.62-2014-541 (227), datë 18.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është regjistruar dhe shortuar në datën 24.10.2013 dhe ka përfunduar në datën 18.02.2014, duke zgjatur gjykimi për rreth 3 muaj e 27 ditë ose 117 ditë, ***brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD (pika 5 gërma “e”).***
- (ii) Çështja që i përket vendimit nr.62-2014-2030 (700), datë 03.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është regjistruar dhe shortuar në datën 10.02.2014 dhe ka përfunduar në datën 03.06.2014, duke zgjatur gjykimi për rreth 3 muaj e 23 ditë ose 113 ditë, ***brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD (pika 5 gërma “e”).***
- (iii) Çështja që i përket vendimit nr.62-2014-1029 (417), datë 01.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është regjistruar dhe shortuar në datën 31.10.2013 dhe ka përfunduar në datën 01.04.2014, duke zgjatur gjykimi për rreth 5 muaj e 2 ditë ose 152 ditë, ***brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD (pika 5 gërma “e”).***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 10 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore të cilat i përkasin dy kategorive “Penale krime” dhe “Civile e përgjithshme me palë kundërshtare”, gjykimi ka përfunduar në çdo rast brenda standardit minimal kohor në fuqi, sipas kriterëve matëse të miratuara me vendimin nr. 261/2, viti 2010, të KLD-së.

Për sa më sipër, duke iu referuar në tërësi kohëzgjatjes së gjykimit për 10 çështjet për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, për shkak se standardi minimal kohor është respektuar nga gjyqtarja për të dyja kategoritë të cilave iu përkasin çështjet e analizuar, gjyqtarja duhet të vlerësohet për këtë tregues me pikët maksimale.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e

analizuara dhe për pasojë, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në lidhje me këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, për shkak se në të gjitha çështjet e analizuara gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykatat e posaçme (Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në periudhën e vlerësimit) dhe nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 7 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.⁴²

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori, rezulton si më poshtë:

⁴²Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 7 çështjet në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezulton të jetë rreth 146 ditë, ose 4 muaj e 26 ditë, *pra më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale të themelit në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda.*
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 3 çështjet në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, rezulton të jetë rreth 127 ditë, ose 4 muaj e 7 ditë, *pra më e gjatë se standardi minimal kohor prej 6 muaj për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm në gjykatën e shkallës së parë.*

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të dy kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, ka qenë dukshëm më e shkurtër se standardi minimal kohor në fuqi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier për afër 10 muaj e pjesën tjetër në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Ajo ka deklaruar se përgjatë periudhës 01.01.2014 - 31.07.2014, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, i janë caktuar 277 çështje civile e penale dhe ka përfunduar 273 çështje. Sipas të dhënave të paraqitura rendimenti i përfundimit të çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier është 98.5%. Në periudhën 01.08.2014 - 31.12.2016 në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ka deklaruar se i janë caktuar gjithsej 461 çështje në total, nga të cilat 275 çështje si kryesuese e 186 çështje si anëtare. Ka përfunduar gjithsej 447 çështje në total, nga të cilat 261 çështje si kryesuese e 186 çështje si anëtare. Në vitin 2016 ka mbartur 3 çështje gjyqësore. Përsa i*

përket rendimentit të përfundimit të çështjeve si kryesues në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, bazuar në këto të dhëna, është 94.9%...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 29.07.2014, gjyqtarja {...} ka përfunduar 363 çështje nga të cilat 128 çështje civile të përgjithshme, 1 çështje penale, 108 kërkesa penale në fazën e hetimit (masa sigurimi) dhe 126 kërkesa civile, ose 129 çështje me palë kundërshtare sipas standardit.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 30.07.2014 – 08.10.2016, gjyqtarja {...} ka përfunduar 94 çështje, nga të cilat 25 çështje penale themeli, 2 çështje me objekt konfiskim pasurie (sipas ligjit antimafia), 2 kërkesa me objekt sekuestro pasurie (sipas ligjit antimafia), 19 kërkesa penale dhe 46 kërkesa penale në fazën e hetimit (masa sigurimi), ose 27 çështje penale sipas standardit.

Referuar të dhënave të pasqyruara në vërtetimin nr.56 prot., datë 12.01.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe vërtetimit nr.3578 prot., datë 24.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, bashkëlidhur Formularit të vetëvlerësimit,⁴³ shënohen të dhënat statistikore të ndara sipas viteve kalendarike dhe konkretisht:

- Në vitin e plotë 2013, i janë caktuar si çështje të reja 378 çështje, ka përfunduar 348 çështje;
- Në vitin 2014 për periudhën janar –korrik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, i janë caktuar si çështje të reja 277 çështje, ka përfunduar 273 çështje, ndërsa në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për periudhën gusht - dhjetor i janë caktuar 43 çështje dhe ka përfunduar 36 çështje, duke mbartur 7 çështje për vitin pasardhës. Në total, për vitin e plotë 2014, gjyqtarës i janë caktuar 298 çështje dhe ka përfunduar 288 çështje;
- Në vitin e plotë 2015, i janë caktuar 108 çështje, ka përfunduar 102 çështje, duke mbartur për vitin pasardhës 6 çështje;
- Në vitin e plotë 2016, i janë caktuar 124 çështje, ka përfunduar 121 duke mbartur për vitin pasardhës 3 çështje.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabela me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së 08.10.2013 - 08.10.2016, duke u bazuar në të dhënat statistikore bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit për periudhën e plotë 2013-2016, e cila në këtë rast konsiderohet periudhë e plotë vlerësimi, rendimenti duhet të përcaktohet referuar

⁴³Faqe 12-15 të dosjes së rivlerësimit.

raportit të çështjeve të përfunduara 880 çështje, me çështjet e caktuara 930 çështje gjatë periudhës së vlerësimit, **në masën 94.6%**.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 94.6%. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 8 pikë. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli”*. Bazuar në këtë parashikim, rezulton se gjyqtarja (i) në vitin 2014, për periudhën 01.01.2014 - 29.07.2014, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier ka përfunduar 102 çështje me palë kundërshtare, ose rreth 45% më shumë se standardit sasior të punës (*duke llogaritur për periudhën 7 mujore*), ndërsa për periudhën 30.07.2014 -31.12.2014 në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka përfunduar 1 çështje penale, duke mos e tej kaluar standardin sasior të punës për gjyqtarin e gjykatës së shkallës së parë për krimet e rënda; (ii) për vitin 2015 ka përfunduar 16 çështje penale, ose rreth 60% më shumë se standardi sasior i punës dhe (iii) për vitin 2016 (*deri në 08.10.2016*) ka përfunduar 10 çështje penale, ose 33% më shumë se standardit sasior të punës (*duke llogaritur për periudhën 9 mujore*), vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që rezulton nga të dhënat statistikore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 10 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e dhëna e vetme objektive për këtë fakt. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara, rezultoi se gjyqtarja {...} i kushton rendësi arsyetimit në kohë të vendimeve. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 1 ditë nga shpallja (shih dosjen 4), për 2 ditë nga shpallja (shih dosjen 1), për 4 ditë nga shpallja (shih dosjen 2), për 5 ditë nga shpallja (shih dosjen 3) dhe për 13 ditë nga shpallja (shih dosjen 5). Pra, 4 vendimet janë arsyetuar brenda afatit ligjor 5 ditor, ndërsa për 1 vendim (shih dosjen 5) afati është kaluar vetëm me 3 ditë nga afati ligjor 10 ditor, por brenda afatit të paraqitjes së ankimit nga palët në proces, i cili është 15 ditë, ndërkohë që palët nuk kanë paraqitur as ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë në shkallë të parë. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit {...} e respekton kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, duke respektuar afatet standarde të gjykimit të çështjeve, si dhe i kushton rendësi kohës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor”.*

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Ndërsa referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte parashikuar 10 ditë (neni 308 paragrafi 2), me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar të vendimit me 5/ditë. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10-ditor i ankimit ndaj vendimit penal dhe afati 10-ditor i arsyetimit të vendimit civil sipas parashikimeve të nenit 308/2 të K.Pr.Civile.

Sa më sipër, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

- (i) Çështja penale nr. 29/178 regj., datë regjistrimi 20.11.2014, e përfunduar me vendimin nr.14, datë 04.02.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, rezulton të jetë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 06.02.2015, pra 2 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (ii) Çështja penale nr. 129 regj., datë regjistrimi 03.06.2016, e përfunduar me vendimin nr.91, datë 30.06.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, rezulton të jetë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 04.07.2016, pra 4 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (iii) Në çështjen penale nr. 407 regj., datë regjistrimi 18.09.2015, me objekt "*Vleftësim arrësit dhe caktim mase sigurimi*", përfunduar me vendimin e datës 19.09.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 24.09.2015, pra 5 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (iv) Në kërkesën nr. 19 regj., datë regjistrimi 26.07.2016, me objekt "*Sekuestrim i pasurisë, sipas ligji 10192/2009*", përfunduar me vendimin nr.13, datë 27.07.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 08.11.2013, pra 1 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (v) Në çështjen civile nr. 11216-02623-62-2013 (2129/264) regj., datë regjistrimi 24.10.2013, me objekt të padisë "*Zgjidhje e kontratës së qirasë*", përfunduar me vendimin nr.62-2014-541 (227), datë 18.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 03.03.2014, pra 13 ditë nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile, duke e tejkalluar këtë afat me 3 ditë;
- (vi) Në çështjen civile nr. 21264-00253-62-2014 (635) regj., datë regjistrimi 10.02.2014, me objekt të padisë "*Dëmshpërblim që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës*", përfunduar me vendimin nr.62-2014-2030 (700), datë 03.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 13.06.2014, pra 10 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (vii) Në çështjen civile nr. 11232-02696-62-2013 (2184/219) regj., datë regjistrimi 31.10.2013, me objekt të padisë "*Njohje pronar me parashkrim fitues*", përfunduar me vendimin nr.62-2014-1029 (417), datë 01.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 09.04.2014, pra 8 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (viii) Çështja penale nr. 93 regj., datë regjistrimi 03.04.2015, e përfunduar me vendimin nr.74, datë 10.06.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, rezulton të jetë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 15.06.2015, pra 5 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (ix) Në çështjen penale nr. 193 regj., datë regjistrimi 28.04.2015, me objekt "*Caktim mase sigurimi*", përfunduar me vendimin e datës 29.04.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 04.05.2015, pra 5 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10

ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;

- (x) Çështja penale nr. 09/104 regj., datë regjistrimi 17.04.2015, e përfunduar me vendimin nr.76, datë 30.05.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, rezulton të jetë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 03.06.2016, pra 4 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (xi) Në çështjen penale nr. 32 regj., datë regjistrimi 12.02.2016, me objekt “Caktim mase sigurimi”, përfunduar me vendimin e datës 15.02.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 17.02.2016, pra 2 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Referuar çështjeve sipas kategorive të tyre, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar për kategorinë:

- (i) “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” është 8 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor i përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (ii) “Penale krime” është 3.7 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016;
- (iii) “Kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak”, është 4 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar për të gjitha kategoritë për të cilat ka të dhëna, rezulton të jetë “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JOPRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Për subjektin e rivlerësimit u përzgjedhën 5 dosje me short 4 çështje i përkasin periudhës së gjykimit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe 1 dosje periudhës së gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Nga 5 dosjet e vëzhguara rezulton se: 3 prej dosjeve të vëzhguara kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosjet 2, 3 e 4) dhe dy dosje kanë përfunduar me 6 seanca (shih dosjet 1 e 5). Dosja 5 i përket çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier e cila i përket periudhës së rivlerësimit 08.10-2013-30.07.2014. Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 15 seanca të zhvilluara prej saj, nga të cilat 9 prej këtyre seancave kanë qenë produktive dhe 6 seanca kanë qenë joproduktive (shih dosjet 1 e 5). Në asnjë rast, seancat nuk kanë dështuar për shkak të subjektit të rivlerësimit, në të gjitha rastet shkak për shtyrjen është bere sjellja e palëve në proces, mosparaqitja e avokatit të zgjedhur, e prokurorit, kërkesa për tu njohur me aktet apo kërkesa për shtyrje të palëve në proces për shkak të gjendjes shëndetësore (raport mjekësor). Subjekti i rivlerësimit është kujdesur që të pandehurit të realizojnë të drejtën e mbrojtjes me avokat në procesin penal. Në çështjen penale të zhvilluar me 6 seanca gjyqësore, ato janë shtyrë brenda distancës procedurale kohore 15 ditore, të parashikuara në nenin 342/2 të Kodit të Procedurës Penale (shih dosjen 1). Edhe në çështjen civile të zhvilluar po me 6 seanca gjyqësore, ato janë shtyrë në distanca kohore të arsyeshme nga 3-28 ditë dhe çështja ka përfunduar brenda afatit standard 6 mujor....”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.⁴⁴

Nga tërësia e të dhënave rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 7 çështjet e vëzhguara që i përkasin kategorisë së çështjeve me palë kundërshtare (çështje civile themeli dhe çështje penale) varion nga 1 deri në 34 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 6.7 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë *“Civile të përgjithshme me pale kundërshtare”* dhe 11.5 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë *“Penale krime”*.

⁴⁴Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përjashtuar ato pa palë ndër gjyqësore. Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Numri mesatar i seancave gjyqësore për të 7 çështjet me palë kundërshtare të analizuara, rezulton të jetë 9.4 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtarja ka kryer me korrektësi dhe efikasitet veprimet procedurale për vënien në lëvizje të dosjeve brenda një kohë të shkurtër nga 0 deri në 7 ditë nga momenti i caktimit të tyre me short. Rezulton se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët apo mos zhvillimin i seancave përgatitore dhe gjyqësore për shkak të mungesës së tyre. Konstatohet nga aktet në dosjeve burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me vendim për caktimin e seancës përgatitore apo kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, në referim të nenit 158/a të K.Pr.Civile dhe vendimin për caktimin e seancës gjyqësore në referim të nenit 333 të K.Pr.Penale dhe duke pasqyruar në këto akte në mënyrë të qartë urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kriterëve të parashikuara në K.Pr.Civile apo K.Pr.Penale.

Seancat gjyqësore rezultojnë se janë shtyrë për shkaqe të përligjura dhe kryesisht për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse dhe mbrojtësit të saj për shkaqe të përligjura; me kërkesë të palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim; për njoftimin e dëshmitarëve të kërkuar nga prokurori apo mbrojtja, për shkak të mosparaqitjes së prokurorit, për të dhënë kohë prokurorit apo mbrojtës të të pandehurit për përgatitjen e konkluzioneve, etj. Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosfomimit të trupit gjykues apo angazhimit të anëtarëve të trupit gjykues në aktivitete trajnuese, rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë shumë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit.⁴⁵

Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale, përveçse kur kjo ka qenë objektivist e pamundur (*për shkak të pushimeve në muajin gusht*), por edhe në çështjet civile konstatohet se gjyqtarja cakton përgjithësisht seanca të afërta në kohë nga njëra – tjetra jo më shumë se 1 muaj larg.

Konstatohet se në rastet kur palët apo përfaqësuesit e tyre janë bërë shkak për zvarritjen e gjykimit, gjyqtarja u ka bërë vërejtje, për të mos u përsëritur më e njëjta situatë.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë

⁴⁵Në çështjen me nr.76 vendimi, datë 30.05.2016, seanca e datës 26.06.2015 është shtyrë për në datën 02.07.2015 (pas 6 ditw), seanca e datës 22.10.2015 është shtyrë për në datën 30.10.2015 (pas 8 ditw) dhe seanca e datës 23.11.2015 është shtyrë për në datën 27.11.2015 (pas 4 ditw).

kundërshtare është mbi 3 seanca, por nga ana tjetër gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 9.4 seanca gjyqësore, numër i cili është rritur në mënyrë të konsiderueshme vetëm si rezultat i dosjes nr.10, e shortuar pas fillimit të procedurës së vlerësimit për periudhën 2013-2016, për të cilën janë zhvilluar 34 seanca, (nga të cilat 3 seanca janë shtyrë për mosformim të trupit gjykues, 3 për mosparaqitje të prokurorit, 6 seanca për mosparaqitje të mbrojtësve dhe rreth 10 seanca për pyetje e dëshmitarëve, të pandehurve, kryerjen e ballafaqimit), si dhe gjithashtu gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet dhe në të gjitha rastet konstatohet se seancat janë shtyrë për shkaqe të pavarura nga vullneti i gjyqtarës.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Prandaj pavarësisht se numri mesatar i seancave është më i lartë se 3, gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, sepse ajo ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproductive.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Dosjet e vëzhguara janë venë në lëvizje shpejt, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës gjyqësore. Në dosjet penale të vëzhguara, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës gjyqësore (shih dosjet 1, 2), vendime të cilat janë marrë në të njëjtën ditë me marrjen e çështjes me short dhe 7 ditë nga shorti, sipas parashikimeve të nenit 333 të K.Pr.Penale. Në dy çështjet e tjera penale, vendimi është marrë ditën që i është caktuar çështja për gjykim si gjyqtare e gatshme, për tu gjykuar shpejt sipas afateve procedurale e ligjore të parashikuara për ato lloj çështjesh. Në çështjen civile, vendimi i caktimit të seancës përgatitore është hartuar me akt të veçantë, ndërsa vendimi i kalimit të çështjes për gjykim është pjesë e procesverbalit të veprimeve përgatitore (shih dosjen 5)... Zhvillimi i seancave gjyqësore për dosjet penale të vëzhguara, është në sallë gjykimi, duke e dokumentuar rregullisht këtë veprim dhe me regjistrim audio. Nga ana tjetër, është konstatuar se në 3 prej tyre seancat kanë filluar me vonesë (shih dosjet 1, 2 e 3) dhe shkaku i vonesës është dokumentuar në procesverbal. Megjithatë, vonesat më të mëdha në intervalin nga 18-21 minuta nuk kanë shkaktuar pasoja të dukshme për palët në proces dhe seanca ka vijuar rregullisht. Lidhur me çështjen civile të vëzhguar konstatohet se seancat gjyqësore nuk dokumentohet nëse janë zhvilluar në sallë gjykimi, si dhe nuk janë regjistruar audio. Në analizën e kësaj të dhënë duhet mbajtur në konsiderate infrastruktura e dobët që ka pasur kjo gjykatë, në periudhën tetor-shkurt 2014, me 12-16 gjyqtarë e gjithsej 4 salla gjykimi, sipas emailit të dërguar nga kancelarja e kësaj gjykate datë 01.07.2019, printuar nga e-maili zyrtar datë 15.07.2019. Ajo zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatit dhe hetimit gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar. Për çdo kërkesë apo hap procedural, merr rregullisht mendimin e të dyja palëve në gjykim. Disponon me vendime të ndërmjetme të arsyetuara për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit. Ajo ka respektuar të drejtën e palëve për të siguruar mbrojtësin në proceset gjyqësore të vëzhguara”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 7 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtare dhe 4 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore në çështjet civile, në çdo rast 1 deri 4 ditë pas caktimit të çështjes me short dhe në çështjet penale, brenda 10 ditëve nga caktimi me short, duke respektuar afatin procedural 10 ditor të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale. Në çështjen me karakter emergjent, e cila është kërkesë e fazës së hetimit paraprak, seanca është caktuar menjëherë pas regjistrimit dhe shortimit të saj dhe gjykimi është planifikuar dhe përfunduar ditën e nesërme. Po kështu, edhe në çështjen me objekt “Sekuestrim i pasurisë, sipas ligjit nr.10192/2009” seanca është caktuar menjëherë me regjistrimin e kërkesës në gjykatë dhe ka përfunduar ditën e nesërme, duke respektuar afatin ligjor 5 ditor të përcaktuar nga ligji i posaçëm “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Seancat gjyqësore për 4 dosjet që i përkasin çështjeve penale të themelit, janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale. Në rastin e shqyrtimit të kërkesave së prokurorisë në lidhje me kërkesat penale të hetimit paraprak për vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi apo sekuestrimin e pasurisë, gjyqtarja ka marrë masa efektive për të mundësuar planifikimin dhe zhvillimin e seancave brenda afatit ligjor 48 orësh në rastin e vleftësimit të arrestit dhe brenda 5 ditëve në rastin e vendosjen e masës së sekuestros preventive në zbatim ligjit antimafia, duke respektuar parashikimet e nenit 12 të këtij ligji.

Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*), në kërkesën penale (*nenet 259 dhe 341 të K.Pr.Penale*) apo në çështjen penale të themelit (*neni 335 e vijues dhe 405 i K.Pr.Penale*). Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, marrjen e vendimeve për zhvillimin e gjykimit në mungesë, sipas parashikimeve të nenit 179 të K.Pr.Civile, apo sipas parashikimeve të nenit 351 dhe 352 të K.Pr.Penale, sipas rastit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në rastin e çështjeve penale*), lejimin dhe administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, shoqërimin e të pandehurve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet civile të vëzhguara përgjithësisht janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore të mbajtur me shtypshkrim nga sekretarja gjyqësore, vetëm në disa raste seancat janë mbajtur edhe me sistemin e regjistrimit audio, siç referohet në raportin analitik të rivlerësimit, këtu ka ndikuar infrastruktura e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku në periudhën e vlerësimit kanë ushtruar detyrën 16 gjyqtarë, ndërkohë që ka pasur vetëm 4 salla gjykimi ku proceset regjistrohen në sistemin audio, ndërsa seancat për gjykimet e zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda janë regjistruar në sistem audio dhe janë dokumentuar nëpërmjet shënimeve të mbajtura nga sekretarja gjyqësore për ecurinë e gjykimet.

Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa 2 deri në 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimet, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë konstatohet edhe një numër seancash të filluara me më shumë se 18 minuta deri në 41 minuta vonesë nga ora e planifikuar (11 seanca). Në tërësi pavarësisht fillimit me vonesë të disa prej seancave gjyqësore, të cilat rezultojnë në një përqindje të vogël në raport me seancat e analizuar (16% e seancave rezultojnë të filluara me vonesë) nuk rezulton që ato të kenë sjellë pasoja në produktivitetin e gjykimet të çështjes. Shkaku i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas relativitetit të gjyqtarës lidhet me pjesëmarrjen e anëtarëve të trupit gjykues në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar, apo edhe në pritje të paraqitjes së prokurorit

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimet penal ose civil, në seancat përgatitore dhe ato gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta, të plota dhe të administruara në dosje në mënyrë kronologjike. Procesverbali gjyqësor në 4 çështjet penale të vëzhguara, dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në këto dosje gjyqësore, konstatohet se dokumentohet shkaku i vonës së çeljes së seancave gjyqësore. Përsa i përket dosjes civile të vëzhguar në procesverbalin gjyqësor nuk është dokumentuar koha e çeljes dhe mbylljes së seancës gjyqësore”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes në çështjen penale fillon me aktin e shortit, vijon me urdhrin e formimit të turpit gjykues, vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, shkresat për shoqërimin e të pandehurit, kërkesat e paraqitura gjatë gjykimit, provat e administruara për herë të parë në dosje për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave sipas datave, diskutimet me shkrim të palëve dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Renditja e dosjes në çështjet civile fillon me aktin e shortit, vijon me vendimin e gjyqtarës për caktimin e seancës përgatitore, kërkesëpadinë, provat, prapësimet e palës së paditur, aktin e përfaqësimit, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalin e seancës përgatitore, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesa penale apo padia për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, pretendimet përfundimtare të palëve, konkluzionet e prokurorit, aktet e njoftimit të palëve, përfaqësonit të tyre, provat etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Dosja është sistemuar në mënyrë kronologjike në reference të rregullave procedurale duke u bërë lehtësisht e shfrytëzueshme për palët”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, vendimet gjyqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (padia dhe provat shkresore të palës paditëse, provat e palës së paditur, provat e administruara për herë të parë në seancë për shkak të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës {...}. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt. Ka 2 ankesa (1 ankesë e vitit 2013 dhe 1 ankesë e vitit 2014), të cilat janë verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mosrespektim formal të ligjit, ku është sugjeruar për gjyqtaren tërheqje vëmendje me shkrim. Nga ana tjetër, për gjyqtaren {...}, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë mase disiplinore (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së).

Së fundmi, duhet evidentuar se nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt. Nuk është konstatuar ndonjë seancë gjyqësore e dështuar për shkak të subjektit të rivlerësimit. Ka patur vonesa në fillimin e seancave nga 7-21 minuta, ku shkak i tyre është evidentuar në procesverbalin gjyqësor, por vonesat nuk kanë sjellë pasoje për palët në proces dhe gjykimi ka vijuar rregullisht. Nga analiza e tyre konkludohet se ato lidhen me aftësitë organizative të gjyqtarës dhe jo me disiplinën në punë të saj”.

Nga aktet e dosjes së rivlerësimit, rezulton se në të nuk janë administruar aktet lidhur me verifikimin e ankesave. Për këtë arsye, u administruan nga arkiva e KLGJ, aktet përkatëse për verifikimin e secilës ankesë. Nga administrimi i tyre rezulton se, pas trajtimit, ankesat janë arkivuar dhe vetëm 2 prej tyre, përmbajnë të dhëna që përbëjnë burim vlerësimi e që lidhen me kriterin e “Aftësive Organizative” të gjyqtarës.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD, trajtuar gjerësisht në pjesën e parë të këtij Raporti, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarës.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarën {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.241, datë 26.02.2020 rezulton se për subjektin e rivlerësimit {...} janë paraqitur 3 denoncime, për të cilat KPK pas analizimit të dokumentacionit të administruar, i ka gjetur të pabazuara. Në vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit me nr.20, datë 14.06.2022, nuk rezultojnë të jenë verifikuar apo trajtuar çështje që mund të ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës, posaçërisht në drejtim të etikës së saj në punë.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi** :Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.*

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.*

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit 2013-2016, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren janë paraqitur gjithsej 3 ankesa në Inspektoratin e ish KLD.⁴⁶ Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së me nr. 241, datë 26.02.2020 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit me vendimin nr.20, datë 14.06.2022 në lidhje me etikën, kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe figurës, ka konkluduar si vijon: *“Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se: i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; ii. subjekti arrin*

⁴⁶Sikurse pasqyrohet në pjesën e dytë të këtij projektraporti, të titulluar “Burimet e vlerësimit”

nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe: iii. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale”.

Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në vendimi nr. 20, datë 14.06.2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, konkludohet se: *“21.Në mbështetje të sa më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve, provave dhe legjislacionit të zbatueshëm. 22. Kolegji, në përfundim, e gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. {...} dhe, për pasojë, ai duhet të lihet në fuqi”.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë nën kriter, konkludohet se: *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për vetë gjyqtaren, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me konceptin e gjykatës së paanshme”.*

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Për vetë gjyqtaren, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve”*.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtares, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares vlerësohet si *“I pakonsiderueshëm”*.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”.*

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar konkludohet se: *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, është konstatuar se komunikimi ka qënë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore dhe në akte tek 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”.*

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre dhe në çdo rast duke respektuar normat e komunikimit zyrtar dhe etik.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*institucioneve të paraburgimit, drejtorive të policisë etj, për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, etj.*) në aktet shkresore është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi : Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nga analiza rezulton se janë 15 seanca gjyqësore të vëzhguara, nga të cilat 6 seanca të caktuara nuk kanë qenë produktive, por në të gjitha rastet shkak për shtyrjen është bërë sjellja e palëve në proces. Në këtë aspekt duhet evidentuar se nuk janë konstatuar seanca gjyqësore të dështuara nga planifikimi për shkak të subjektit të rivlerësimit. Ndonëse janë evidentuar raste, që të këtë patur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, apo dështim të seancave të planifikuara, këto nuk kanë ardhur për shkak të mungesës së bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Vendimet gjyqësore janë arsyetuar brenda afatit ligjor 5 ditor, lidhur me çështjet penale të gjykuara, me përjashtim të 1 rasti, në çështjen civile të vëzhguar, ku vonesa në arsyetimin e vendimit ka qenë 3 ditë nga afatit 10 ditor dhe brenda afatit të ankimit për palët në proces, çka tregon se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur, ndonëse për çështjen palët ndërgjyqëse nuk kanë paraqitur ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë në shkallë të parë.”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e

nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi; Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi, si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit te papërshtatshëm, përjashtimit social etj., vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtares me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar konkludohet se: “Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 18 trajnime nga Shkolla e Magjistraturës (shih të dhënat tek Trajnimet në 3 Vitet e Fundit). Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 29 ditë të formimit vazhdues për një periudhe trevjeçare. Lënda e trajnimit ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtares të shkallës së parë në çështjet civile e penale. Ka marrë pjesë dhe në 4 trajnime të tjera në Shkollën e Magjistraturës të cilat janë jashtë periudhës së rivlerësimit dhe i përkasin periudhës 31 tetor-15 dhjetor 2016. Gjithashtu ka deklaruar se ka marrë pjesë në 2 trajnime të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, nga te cilat 1 është brenda periudhës 3 vjeçare të rivlerësimit konkretisht trajnimi “Diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve të dala nga studimi për ndëshkueshmërinë e veprave penale të korrupsionit në sektorin publik”, më 29 shtator 2016, organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, mbështetur nga Ambasada e SHBA”.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHduES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në 22 aktivitete trajnuese, në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në të gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej në 35 ditë trajnim.

Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnime jashtë Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të cilat rezultojnë të jenë aktivitete të formimit profesional. Konkretisht, gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnimin me temë “Diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve të dala nga studimi për ndëshkueshmërinë e veprave penale të korrupsionit në sektorin publik”, e organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në datën 29 shtator 2016.

Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në 23 aktivitete trajnuese, në programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë tij, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 36 ditë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës civile dhe penale, gjithsej 23 aktivitete të zhvilluara për 36 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufijve ligjore 15-120 ditë, dhe pikëzohet me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

- Dosja personale e gjyqtares;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

***Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësohet se në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.*

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËRINSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2013-2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të

tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimsdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjisllacionit etj.

Lidhur me këtë tregues në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se;”Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjisllacionit; aktivitete mësimsdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike”.

Lidhur me këtë tregues, gjyqtarja paraqiti kundërshtime dhe kërkoi pikëzim maksimal, duke pretenduar se ka kontribuar në veprimtari ndërinstitucionale, konkretisht duke marrë pjesë në procesin e konsultimeve për Reformën në Drejtësi. Për të provuar këtë, gjyqtarja paraqiti në cilësinë e provës, vërtetimin nr.13 prot., datë 13.03.2024 të Kuvendit të Shqipërisë, lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Shërbimit Legjisllativ, me anë të cilës vërtetohet se gjyqtarja ka marrë pjesë në tryezat e punës konsultuese të organizuara nga Kuvendi nga Komisioni i Posaçëm për Reformën në Drejtësi, në kuadër të përgatitjes së paketës së projektligjeve të reformës në drejtësi.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi : Referuar sa më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Sipas formularit të vetëvlerësimit profesional, akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe dosjen personale të gjyqtares, nuk rezultojnë të dhëna për publikime ligjore akademike, gjatë periudhës së vlerësimit.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se, për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtares dhe për këtë shkak do të pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave	100	Shkëlqyeshëm

profesionale		
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	393	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013 - 2016**

1. AFTËSITË PROFESIONALE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Treguesit	Burimet	Niveli	Piket	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë

		<i>dosjet e përzgjedhura me short);</i>			Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të 	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë

		përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);			31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	+99% - 10 pikë	10	Tej standardit : Nën 81 %- 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë

	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	b. Dosja e rivlerësimit; c. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit	c. Dosja e rivlerësimit; d. Aktet e çështjeve të	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:

	gjqësor	përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);			E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë

					Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Piket total	Niveli i vlerësimit
				93	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Aftësia e	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të 	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit:

komunikimit		përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);			E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare)

veprimtari të tjera	profesionale				15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	<ul style="list-style-type: none"> Dosja e rivlerësimit; 	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	<ul style="list-style-type: none"> Dosja e rivlerësimit; 	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimi ligjore akademike	<ul style="list-style-type: none"> Dosja e rivlerësimit; 	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
NIVELI I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT		Shkëlqyeshëm			
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		393			

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

